

POLITIKA E CILËSISË

Agjencia për Komunikimet Elektronike **inkurajon konkurrencën** në sigurimin rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, shërbimeve shoqëruese dhe **kontribuon në zhvillimin e tregut të vetëm europian**, duke promovuar **interesat e përdoruesve fundorë** dhe duke zbatuar parimet rregullatore të objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit.

Agjencia për Komunikime Elektronike **mbron interesat e përdoruesve fundorë** nëpërmjet sigurimit të shërbimeve të komunikimit elektronik me cilësi, siguri dhe disponueshmëri të lartë, me çmime të justifikuar dhe konkurruese në treg.

Agjencia për Komunikime Elektronike përpiqet të rrisë kënaqësinë e përdoruesve nëpërmjet vendosjes së sistemit të shpejtë, efikas, transparent dhe të orientuar drejt përdoruesit, me procedura të thjeshtuara për ushtrimin e të drejtave të tyre.

Agjencia për Komunikime Elektronike përpiqet të përparojë vazhdimisht zhvillimin e teknologjive të komunikimit, duke përfshirë rrjetet me brez të gjerë (broadband) dhe 5G, si dhe duke monitoruar dhe zbatuar vazhdimisht trendet europiane dhe globale në fushën e komunikimeve elektronike.

Agjencia për Komunikime Elektronike **menaxhon me spektrin e radiofrekuencave**, duke siguruar përdorimin e tij efikas dhe të pandërprerë.

Agjencia për Komunikime Elektronike **zhvillon marrëdhënie partneriteti me operatorët dhe palët e tjera të interesuara**, në drejtim të rregullimit transparent dhe efikas të tregut të komunikimeve elektronike.

Agjencia për Komunikime Elektronike përpiqet të zhvillojë dhe zbatojë **qasje sistematike dhe procesuale në punën e saj**, bazuar në menaxhimin e rrezikut, me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike me cilësi të lartë.

Agjencia për Komunikime Elektronike kryen **identifikimin, planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe kontrollin, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të të gjitha proceseve** që kanë ndikim mbi cilësinë e shërbimeve.

Agjencia për Komunikime Elektronike përpiqet të mbajë ekip me personel me kualifikim të lartë, profesional dhe të motivuar.

Agjencia për Komunikime Elektronike **siguron mbikëqyrje, koordinim dhe reagim ndaj incidenteve të sigurisë**, si dhe **identifikimin e rreziqeve dhe kërcënimeve ndaj subjekteve të infrastrukturës thelbësore, të rëndësishme dhe kritike në vend**.

Agjencia për Komunikime Elektronike është e përkushtuar për të përmbushur kërkesat e zbatueshme të standardeve ndërkombëtare **ISO 9001:2015, ISO 45001:2018 dhe ISO 14001:2015** dhe për të përmirësuar vazhdimisht sistemin e integruar të menaxhimit, me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësore, mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve dhe minimizimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor.

Politika e cilësisë është adekuate për qëllimin dhe kontekstin e Agjencisë për Komunikime Elektronike dhe ofron kornizë për përcaktimin e objektivave të cilësisë.

Numri ynë
Shkup

0201-46/11
27-07.2026

Drejtor
Nusret Haliti

